



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Nr. 15 Prot.

Tiranë, më 07.03. 2025

VENDIM

Nr. 95, Datë 07.03.2025

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit (komisioni) në mbledhjen e tij të datës 07.03.2025 ku morën pjesë:

- Znj. Arsiola Dyrmishi Kryetare
- Z. Gentjan Thoma Anëtar
- Znj. Anairda Arizaj Anëtare
- Znj. Ersida Teliti Anëtare

vijoi shqyrtimin e ankesës së konsumatorëve E.D, B.T, A.K dhe O.Gj. kundrejt subjektit tregtar “Vivere Ticketing” Sh.p.k.

Komisioni pasi dëgjoi informacionin e përgatitur nga Sekretariati teknik dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij,

VËREN SE:

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, Bashkia Tiranë, nëpërmjet shkresave nr.10765, datë 06.12.2024, nr.E-10644/1, datë 06.12.2024 dhe nr.11048, datë 11.12.2024 ka përcjellë pranë komisionit ankesat e konsumatorëve E.D., B.T., A.K. dhe O.Gj. kundrejt subjektit tregtar “Vivere Ticketing” Sh.p.k.

Ankesat janë administruar pranë komisionit me numër protokolli 91, datë 19.12.2024, 90, datë 19.12.2024 dhe 93, datë 26.12.2024.

Konsumatorët E.D., B.T., A.K. dhe O.Gj. kanë blerë bileta nga shoqëria “Vivere Ticketing” Sh.p.k për koncertin “Dire Straits Legacy” i cili duhej të zhvillohej më datë 31.08.2024. Më pas nga ana e shoqërisë konsumatorët janë njoftuar me email se për arsye atmosferike koncerti ishte anuluar dhe se do të rimbursoheshin plotësisht për çmimin e biletave, ndërsa komisionet bankare nuk do të rimbursoheshin. Procesi i rimbursimit do të zgjaste 30 ditë dhe, nga ana e shoqërisë do të ndiqeshin me përpikmëri afatet e përcaktuara. Më pas, kompania, nisur nga interesimi i konsumatorëve, ka sqaruar me email se ka një vonesë për rimbursimin e biletave të eventit të “Dire Straits Legacy” pasi shoqëria është në pritje të kthimit të fondeve në llogarinë e saj dhe afati i rimbursimit në këtë rast zgjat deri në 90 ditë. Duke qenë se deri në datë 26.11.2024 konsumatorët nuk ishin rimbursuar ato i janë drejtuar fillimisht me ankesë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë, e cila në vijim i ka përcjellë ankesat pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit nëpërmjet shkresave nr.10765, datë 06.12.2024, nr.E-10644/1, datë 06.12.2024 dhe nr.11048, datë 11.12.2024 (protokolluar pranë komisionit me nr.91 datë 19.12.2024, nr.90 datë 19.12.2024 dhe nr.93 datë 26.12.2024).

- **Lidhur me kompetencën e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit**

Së pari, shoqëria “Vivere Ticketing” Sh.p.k, është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) M02401018M, me aktivitet të shërbimit në fushën e tregtimit të biletave në vend ose në distancë (on-line sipas një platforme kompjuterike) për koncerte, festivale, evente, si dhe për çdo organizim me karakter kulturor dhe artistik.

Në kuptim të përkufizimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 e ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar, subjekti plotëson kërkesat ligjore për t’u klasifikuar si “tregtar”, pasi është subjekt, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike dhe/ose tregtinë.

Së dyti, çështja është objekt shqyrtimi, pasi konsiston në një marrëdhënie midis tregtarit dhe konsumatorëve dhe rrjedhimisht brenda fushës së zbatimit të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar dhe në kompetencë të Komisionit.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se, shqyrtimi i ankesës së lartpërmendur është në kompetencë të saj.

Bazuar në VKM-në nr.1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”, pika 3, shkronja (a) parashikon se:

“3. Komisioni ka përgjegjësinë të shqyrtojë shkeljet e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, për:
a) praktikat e padrejta tregtare”.

- **Vlerësimi i praktikës**

Komisionit i janë përcjellë nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Bashkia Tiranë ankesat e konsumatorëve E.D., B.T., A.K. dhe O.Gj. kundrejt shoqërisë “Vivere Ticketing” Sh.p.k. Në mbledhjen e datës 15.01.2025, Komisioni vendosi fillimin e hetimit administrativ për shoqërinë “Vivere Ticketing” Sh.p.k. Me anë të shkresës me nr.90/1, datë 31.01.2025 i është bërë me dije subjektit “Vivere Ticketing” Sh.p.k se pranë komisionit janë përcjellë ankesat e konsumatorëve të sipërcituar dhe nga ana e komisionit ka filluar hetimi administrativ, si dhe është kërkuar që brenda datës 14 shkurt 2025 të dërgohet një informacion i plotë sqarues dhe dokumentacion si nga shoqëria edhe nga konsumatorët në lidhje me sa pretendohet prej këtyre të fundit. Shkresa nr.90/1, datë 31.01.2025 i është dërguar shoqërisë “Vivere Ticketing” Sh.p.k dhe konsumatorëve E.D., B.T., A.K. dhe O.Gj. edhe në rrugë elektronike me email-in e datës 04.02.2025.

Komisioni në mbledhjen e datës 07.03.2025, mori në shqyrtim përgjigjet e ardhura në vijim të shkresës së saj nr.90/1, datë 31.01.2025 dhe konkretisht:

- Shoqëria “Vivere Ticketing” Sh.p.k me shkresën nr.125, datë 04.02.2025 (administruar pranë KMK-së me numër prot.90/2, datë 06.02.2025) informon komisionin se ka rimbursuar konsumatorët B.T., A.K., O.Gj., ndërsa konsumatorja E.D. nuk është rimbursuar për shkak të mungesës së komunikimit.
- Konsumatori B.T. nëpërmjet emailt të datës 04.02.2025 dërguar komisionit ka konfirmuar se është rimbursuar nga shoqëria “Vivere Ticketing” Sh.p.k;
- Konsumatori O.Gj. nëpërmjet emailt të datës 05.02.2025 dërguar komisionit ka konfirmuar se është rimbursuar nga shoqëria “Vivere Ticketing” Sh.p.k;

- Konsumatori A.K. nëpërmjet emailt të datës 06.02.2025 dërguar komisionit ka konfirmuar se është rimbursuar nga shoqëria "Vivere Ticketing" Sh.p.k;
- Konsumatori E.D. nëpërmjet emailt të datës 04.02.2025 dërguar komisionit ka konfirmuar se është rimbursuar nga shoqëria "Vivere Ticketing" Sh.p.k;

Për sa më sipër, në kushtet kur konsumatorët konfirmojnë se janë rimbursuar nga tregtari, komisioni konsideron se mosmarrëveshja është zgjidhur mes palëve dhe nuk ka arsye ligjore për të vijuar më tej procedurën e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, mbështetur në nenin 52, të Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, dhe në pikën 2, të VKM-së nr.1444, datë 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e të pagesës se anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve",

VENDOSI:

1. Pushimin e hetimit administrativ kundrejt shoqërisë "Vivere Ticketing" Sh.p.k.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Kundër këtij vendimi keni të drejtë të ankoheni në gjykatën kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

ARSIOLA DYRMISHI

